



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2025:005824

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06775524

KA.nr.17/2025

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit KOMUNA E PEJES, me përfaqësues të autorizuar Drita Sopi Gashi Avokate, kundër të paditurës 1). Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor Infrastruktura, dhe 2). New Green Market LLC, me kërkesëpadi për anulim të vendimit të A.158/24 dt. 06.12.2024, konform nenit 13 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/I-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), jashtë seancës, më datë 29.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

s

- I. Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative shpallet jo kompetent për të gjykuar këtë çështje.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinës Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridike administrative.

A r s y e t i m

Me datë 14.01.2025, në këtë gjykatë paditësit KOMUNA E PEJES, me përfaqësues të autorizuar Drita Sopi Gashi Avokate, ka parashtruar padi kundër të paditurës 1). Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor Infrastruktura, dhe 2). New Green Market LLC, me kërkesëpadi për anulim të vendimit të A.158/24 dt. 06.12.2024.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale, vlerëson se nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje. Gjykata erdhi në përfundim se nuk është e kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje duke mbështetur në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale që përcaktojnë se “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative” lidhur me par. 5 që përcakton se: “5. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nënparagrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative.” Gjithashtu në nenin 3 par. 1, nën par. 1.10 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar përkufizimi si në vijim: “Shoqëritë Tregtare – të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.

Mbështetur në dispozitat e lartcekura, Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve administrative të iniciuara vetëm nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative. Në këtë çështje, konflikti administrativ nuk është iniciuar nga ndonjë shoqëri tregtare, por nga Komuna e Pejës si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë statusi ligjor i të cilës rregullohet me Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Poashtu. Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare Ligji për Shoqëritë Tregtare, (LSHT) përkufizon Komunat si Autoritet Publik, Neni 3 paragrafi 1.4. përcakton *Autoritet publik - do të thotë çdo autoritet ekzekutiv qeveritar, organ publik, ministri, departament, agjenci, komunë ose autoritete të tjera që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative ose gjyqësore në Kosovë*; Prandaj, në kuptim të LSHT-ës, Komuna nuk mund të konsiderohet Shoqëri Tregtare sepse si autoritet publik ka kompetenca ekzekutive dhe rregullative te vetëqeverisjes lokale dhe nuk ushtron aktivitet ekonomik në kuptim të LSHT-së.

Andaj bazuar në nenin 17 të Ligjit për 06/L-054 për Gjykatat, Gjykata Komerciale vlerëson se për shqyrtimin e kësaj çështje është kompetent Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata bëri shqyrtimin e kompetencës lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KA.nr.17/2025, datë 29.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatën Komeriale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.